



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE FINANCIARE  
DREJTORIA E DREJTIMIT TË BORXHIT PUBLIK

## Shpallja e ofertës fituese

lidhur me propozimet për transaksionin e huas mbështetur në instrumentin financiar të Bankës Botërore, Garancia e Bazuar në Politika (PBG)

Nga datat 02 – 07 prill 2015 në ministrinë e Financave u shqyrtuan ofertat e paraqitura nga bankat për transaksionin e huas mbështetur në instrumentin financiar të Bankës Botërore, Garancia e Bazuar në Politika (PBG), në shumën 250 milionë EUR.

Komisioni përdori si kriter themelor vlerësimi “Vlera aktuale” (*Present Value*), mbasi kjo merr parasysh të gjitha termat me të cilat ofrohet financimi, si maturimi, grace period, interesi dhe kosto të tjera që lidhen me financimet.

Në përfundim të vlerësimit, ministria e Financave shpall fitues ofertën e paraqitur nga Deutsche Bank.

Kjo ofertë plotëson shumën e kërkuar prej 250 milionë EUR me këto terma:

- Marzhi i interesit 1.3% mbi benchmark rate (aktualisht benchmark rate është 0.5%).
- Tarifa e angazhimit 1.25%, e pagueshme vetëm një herë.
- Maturiteti final 10 vjet, me jetë mesatare 8.6 vjet.